



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## Raport i Diskutimit Publik Plani Lokal i Veprimit per Barazi Gjinore 2024-2026

Njësitë për të Drejtat e Njeriut, ZBGJ dhe grupi punues me përkrahjen e UN Women në Kosovë ka përgaditur Planin Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2024 - 2026 si mjeti kryesor i zbatimit të angazhimeve publike për barazinë gjinore. të reflektuara në:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit.
- Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, si dhe tërësinë e ligjeve të vendit të fokusuara tek barazia, mosdiskriminimi dhe fuqizimi i grave.
- Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, si dhe tërësinë e kornizës zhvillimore vendore (programe e strategji) për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.
- Instrumente dhe mjete të BE-së të fokusuara tek barazia gjinore, si pjesë e procesit të integritit, veçanërisht ato që përmbajnë veprimet që duhet të ndërmerren në nivelin lokal – siç është edhe Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

PLVBGJ u përgatit përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike lokale, organizatat e shoqërisë civile, Grupin e Grave, organizatat ndërkombëtare, Kuvendin Komunal dhe me zërat e banoreve dhe banorëve të Komunës së Podujevës, të cilat / cilët patën mundësi të njihen dhe të japin komentet e tyre mbi këtë dokument përgjatë procesit të konsultimit publik.

Plani Lokal i Veprimit për Barazi Gjinore, është përgatitur për diskutim publik, ku ka zgjatë 17 ditë përkatësisht prej datës 27.02.2024 deri më datë 14.03.2024 brenda së cilës kemi mbajtur një Debat Publik me Qytetarë 14.03.2024, duke filluar nga ora 13:30.

Mbrenda kësaj periudhe kohore propozimet, sugjerimet, rekomandimet vërejtjet, kanë pasë mundësinë që të paraqiten, sa ka zgjatë koha e diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike në e-mail adresën; [naime.podvorica@rks-gov.net](mailto:naime.podvorica@rks-gov.net).

Vlen të theksohet se në takimin publik dhe përmes emailit në formë elektronike nuk kemi pranuar komente, vërejtje apo rekomandime për draft Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026

Nr. prot. 02-355/02-0018212/24  
Podujevë, datë 15.03.2024

Raportin e përgatiti  
Naime Podvorica



Formulari per kerkese apo ankese

Drejtorati/Njesia  
Zyra e Kryetarit

Data 15/03/2024

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri

kryetari

Numri personal

0

Adresa e vendbanimit

Nuhi Gashi

E-mail Adresa

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

00000000

2. Mënyra e pranimit

Raport

Statusi i lëndës

Ne proces

Vlera për pagesë: 0.00

Mos shkruani në këtë pjesë

Numri i protokolit

02-355/02-0018212/24

Afati i zgjedhjes

14/04/2024

Vendimi

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Raport i diskutimit publik Plani lokal i veprimit për barazi gjinore 2024-2026.

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë kryetari vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

  
(Nënshkrimi)

\*Ju lutemi të kërkonti nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: Fatime.Hoxha

